



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.970/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Av. Labinot Vata, avokat nga Prishtina, me seli në Prishtinë, rruga “Bardhyl Qaushi”, Kompleksi Kawa, Hyrja D, kati përdhësë, numër 1, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Marigona Berisha, avokate nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Fushë Kosovës, me seli në Fushë Kosovë, rruga “Tahir Zemaj”, nr.2, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.282/23 të datës 15.05.2023, të Përmbartuesit Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, jashtë seancës me datës 13.10.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Fushë Kosovës, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.282/23 të datës 15.05.2023 të Përmbartuesit Privat Blerim Baloku.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.282/23 i datës 15.05.2023 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Blerim Baloku.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve të procedurës përmbartimore për përpilimin e përgjigjes në prapësim të ia paguaj kreditorit shumën prej 117.00 € (njëqind e shtatëmbëdhjetë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit Av. Labinot Vata, në bazë të titullit përmbartues - Marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit në

pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin, ka caktuar urdhrin përbarimor P.nr.282/23 të datës 15.05.2023, me të cilin ka caktuar zbatimin e përbarimit ndaj debitorit Komuna e Fushë Kosovës, që në emër të detyrimit në të holla të përcaktuar në marrëveshjen e ndërmjetësimit nr. 025/2022 të datës 27.12.2022, t'ia paguajë kreditorit të përbarimit Av. Labinot Vata shumën në lartësi prej 312.00 € në emër të përpilimit të padisë, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore, përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor duke theksuar se numrat e lëndës nga P.nr.280/23 e deri tek P.nr.307/23 të datës 15.05.2023 janë të paqartë, ngase është një vazhdim i procedurave dhe obligimeve që ka marrë kreditori nga kontraktuesit e shërbimeve, e që ende pa përfunduar punën kërkon shpërblimin e pjesshëm. Më tutje ka shtuar se kreditori nuk është drejtuar me ndonjë kërkesë zyrtare apo me ndonjë faturë tek debitori në mënyrë që debitori të jetë i informuar, për më tepër kreditori nuk i ka përmbushur detyrimet e veta ndaj debitorit sipas kontratave dhe autorizimeve që ka marr nga kërkuesit e shërbimeve të avokatisë. Debitori ka theksuar se avokati ka vënë në lajthitje debitorin dhe ndërmjetësuesin duke nënshkruar një marrëveshje të dyshimtë dhe pa efekt juridik. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovojë prapësimin e debitorit.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim duke theksuar ndër të tjerash se qëllimi i këtij prapësimi është zvarritja e procedurës përbarimore. Ka shtuar se dokumenti mbi të cilin është lëshuar urdhri përbarimor është marrëveshje për zgjidhjen e ndërmjetësuar i përgatitur dhe lëshuar nga ndërmjetësuesi i licencuar me numër të licencës 58/2011, ku në paragrafin e fundit të marrëveshjes precizohet saktë se ky dokument përmban klauzolën mbi plotfuqishmërinë dhe ekzekutueshmërinë e marrëveshjes dhe e njëjta ka fuqinë e dokumentit përbarues. Në lidhje me pretendimet e debitorit se këtë marrëveshje nuk e ka nënshkruar personi i autorizuar, ky pretendim nuk qëndron pasi që të njëjtën e ka nënshkruar zyrtari ligjor i debitorit. Gjykatës i ka propozuar që të priset urdhri për përbarim, si dhe të detyrohet kreditori që t'ia paguajë shpenzimet në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim konform tarifës së OAK në vlerë prej 234.00 €.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar, andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata gjeti se dokumenti përmbartimor - Marrëveshja e ndërmjetësimit nr. 025/2022 të datës 27.12.2022 është dorëzuar në origjinal dhe i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, i cili përcakton se: *“Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit - vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit”*.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.4, përcaktohen dokumentet përmbartuese siç janë: *“marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit ne pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin;”*, ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumentet përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se urdhri për përmbartim i caktuar mbi bazën e titullit përmbartimor - Marrëveshja e ndërmjetësimit nr. 025/2022 e datës 27.12.2022, i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përmbartues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.4 dhe nenit 27 të LPP-së, pasi që dokumenti përmbartimor është i përmbartueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbartim, pasi që në të janë treguar palët përkatësisht kreditori dhe debitori është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 par.2 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 117.00 €, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifatat e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.970/23, datë 13.10.2023

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.